

**AKTI THEMELIMI I SHOQERISE  
TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO" Sh.p.k**



**ORTAKET**

Ne kuptimin e kesaj kontrate per themelimin e Shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar "FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO" Sh.p.k e cila hap nga ky moment dhe me pas referohet si shoqeri, ortakët jane:

1. Z. Arben Pellumbi, i biri i Servetit, lindur me 1965 ne Korçe, me pasaporte Nr 1581159.
2. Z. Ilir Shtufi, i biri i Xhemalit, lindur me 1973 ne Tirane, me pasaporte nr 1709513.
3. Z. Adrian Doçi, i biri i Skenderit, lindur me 1965 ne Tirane me nr pasaporte 1591064

**QELLIMI**

Qellimi i kesaj kontrate, ne mbështetje te neneve 37 dhe 39 te Ligjit Nr 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" eshte themelimi i Shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar "FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO" Sh.p.k.

**DATA EFEKTIVE**

Kjo kontrate do te jete efektive qe nga data kur, pasi te jete nenshkruar nga ortakët, mbi bazen e saj, te statutit dhe te kerkeses, te jete plotesuar e gjithë procedura ligjore dhe te jete bere regjistrimi i Shoqerise ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane duke u situar zotesia per te vepruar si person fizik.

1. Kjo kontrate, lidhet per nje afat mbi 10 vjet.
2. Shoqeria ka seline e saj ne Vore te Tiranes.
3. Shoqeria do te zhvilloje veprimtarise e saj nepermjet kontributit te te gjithë ortakëve. Ata bien dakort persa kohe nuk do te vendosin ndryshim, te ruajne raportin e kontributeve ne kapitalin themeltar te shoqerise 5000000 (pese milion) leke ne masen 40% Ilir Shtufi, 30% Arben Pellumbi dhe 30% Adrian Doçi, po ne kete mase do te jete edhe perfitimi nga te ardhurat neto te Shoqerise.
4. Objekti kryesor i Shoqerise eshte:

Import - Eksport i mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, materjale ndertimi, minerale te çdo lloji, drure dhe materjale druresore te perpunuara dhe te pa perpunuara, grumbullimi, manipulimi, perpunimi dhe eksporti i bimeve mjekesore dhe aromatike, makineri e pajise te cdo lloji, tregetim mallra te cdo lloji me shumice e pakice, investime direkte dhe indirekte ne prodhim e sherbime, transport nacional dhe nderkombetar te mallrave dhe pasagjereve, komisioner, agjent tregetar e doganor.

Prodhim dhe perpunim betoni.

Ndertimi i linjave dhe fabrikave per prodhimin e materlakeve te ndertimit, i inerteve, soletave te paramenduara, tullave, tjegullave, pllakave majolike, tregetimi e transportimi i tyre me mjetet e shoqerise e per te tretet. Prodhimi e tregetimi i materlakeve hidrosanitare e hidraulike. Prodhimi e tregetimi i ilaceve farmaceutike. Prodhime druresore, alumini, duralu min, plastik, metalor e jo metalor. Transporti i mallrave dhe pajiseve brenda dhe jashte vendit transportimi

i grupeve turistike brenda e jashte vendit, organizimi i ekskursioneve brenda e jashte vendit, me te gjitha llojet e transportit tokesor, detar e ajror, me mjetet e shoqerise dhe te te treteve.

Brenda kuadrit te dispozitave ligjore, shoqeria ka te drejte te marre te gjitha masat dhe e kryete biznes te pershtatshem per arritjen e qellimit te saj.

5. Shoqeria do te drejtohet nga Administratori i saj, me te drejta dhe kopetenca te plota per te zgjedhur e emruar bashkepuntoree e drejtuesit e shoqerise, nenpunesit e te punesuarit, ne perputhje me kerkesat e Legjislacionit Shqiptar.

Ortaket qe mund te vijne ne Shoqeri kane te drejte ti transferojne fitimet e tyre jashte shtetit ne cdo lloj valute a divize, te konvertueshme ne tregun e lire, ose ne nje shoqeri tjeter fitim pruresse pa asnje kufizim.

7. Me vullnetin e lire e te plote te Ortakeve, Shoqeria mund te riorganizohet, te shndrohet ne nje shoqeri te llojit tjeter ne perputhje me kerkesat e ligjit "Per shoqerite tregetare". Gjithashtu ajo mund te likuidohet ose te ndryshoje drejtimin kryesor te saj ne nje veprimtari tjeter ku ka me shume sukses.

8. Mosmarveshjet e mundshme midis ortakeve do te zgjidhen me mirekuptim dhe dialog dhe kur keto nuk japin rezultat, cdo ortak ka te drejte t'i drejtohet Gjykates se Rrethit Tirane me kerkese padi te rregullt. Vendimi i Gjykates se rrethit Tirane eshte i detyrueshem per palet kontraktuese.

9. Me vendim te arsyetuar te Asamblese se Ortakeve, shoqeria ka te drejte te marre kredi nga bankat shqiptare ose nga institucionet nderkombetare te kreditimit qe zhvillojne aktivitet ne Republiken e Shqiperise ose jashte saj.

10. E gjitha veprimtaria ekonomike e financiare e Shoqerise do te evidentohet nepermjet mbajtjes se kontabilitetit ne perputhje me ligjin " Per kontabilitetin ne Republiken e Shqiperise"

11. Te gjitha pasurite e Shoqerise do te regjistrohen ne Regjistrin Themeltar te pasurive te Shoqerise. Te gjitha transaksionet ekonomike e financiare do te kryhen te dokumentuara.

12. Shoqeria ka vulen e saj. Te gjitha dokumentat e nxjerra nga Shoqeria kane vlere ligjore kur jane te nenshkruara nga Ortaket dhe Administratori dhe kane vulen e Shoqerise.

13. Per terheqjen e parave nga banka dhe per pagimin e faturave nga Shoqeria, ato do te paguhen vetem pasi te nenshkruben nga Ortaket ose Administratori ose nga personi i autorizuar prej tyre per te bere pagesen me para ne dore apo nepermjet bankes.

14. Ky akt i themelimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO" Sh.p.k. u perpilua ne kater kopje identike me vlere te njejte ligjore, nga Ortaket Themelues te shoqerise nga te cilat nje depozitohet prane noterit, nje ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe dy kopje ruhen ne seline e Shoqerise.

THEMELUESIT E SHOQERISE  
"FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO" Sh.p.k.


ADRIAN DOÇI



ILIR SHTUFI



ARBEN PELLUMBI



**STATUTI I SHOQERISE**  
**TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO"**



**1. HYRJE**

1.1. Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "FERRO-BETON & CONSTRUCTION CO" Sh.p.k. e cila nga ky moment e me pas referohet si shoqeri, themelohet mbi bazen e iniciatives dhe kapitalit themeltar te ortakeve:

1. Z. Arben Pellumbi, i biri i Servetit, lindur me 1965 ne Korçe, me pasaporte Nr 1581159.
2. Z. Ilir Shtufi, i biri i Xhemalit, lindur me 1973 ne Tirane, me pasaporte nr 1709513.
3. Z. Adrian Doçi, i biri i Skenderit, lindur me 1965 ne Tirane me nr pasaporte 1591064

1.2. Shoqeria krijohet dhe e zhvillon veprimatrine ne perputhje me normal e ketij statuti, te kontrates dhe legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

1.3. Kjo shoqeri, si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, i perballon humbjet deri ne kufirin e kapitalit themeltar.

**2. OBJEKTI**

Objekti kryesor i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

2.1. Import - Eksport i mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, materjale ndertimi, minerale te cdo lloji, drure dhe materjale druesore te perpunuara dhe te pa perpunuara, grumbullimi, manipulimi, perpunimi dhe eksporti i bimeve mjekesore dhe aromatike, makineri e paisje te cdo lloji, tregetim mallra te cdo lloji me shumice e pakice, investime direkte dhe indirekte ne prodhim e sherbime, transport nacional dhe nderkombetar te mallrave dhe pasagjereve, komisioner, agjent tregetar e doganor.

2.2. Prodhim dhe perpunim betoni.

2.3. Ndertimi i linjave dhe fabrikave per prodhimin e materlakeve te ndertimit, i inerteve, solcave te paramenduara, tullave, tjegullave, pllakave majolike, tregetimi e transportimi i tyre me mjetet e shoqerise e per te tretet. Prodhimi e tregetimi i materlakeve hidrosanitare e hidraulike. Prodhimi e tregetimi i ilaceve farmaceutike. Prodhime druesore, alumin, duralumin, plastik, metalor e jo metalor. Transporti i mallrave dhe paisjeve brenda dhe jashte vendit transportimi i grupeve turistike brenda e jashte vendit, organizimi i ekskursioneve brenda e jashte vendit, me te gjitha llojet e transportit tokesor, detar e ajror, me mjetet e shoqerise dhe te te treteve.

Gjithashtu Shoqeria do te kryeje te gjitha veprimet tregtare, ekonomike dhe financiare qe lidhen me objektin kryesor te veprimtarise se saj, qe do te quhen nga drejtuesit te nevojshme ose te dobishme.

### 3. EMRI, SELIA, TERRITORI

3.1. Kjo shoqëri do të emërohet "**FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO**"

3.2. Shoqëria do të ketë qendren e saj në Vore të Tiranës. Në këtë rreth do të zhvillojë dhe aktivitetin e saj kryesor. Selia e Shoqërisë do të jetë në Vore.

3.3. Shoqëria do të zhvillojë veprimtarisë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

3.4. Ajo mund të krijojë filiale ose perfaqësi edhe në rrethet e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

### 4. KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

4.1. Kapitali themeltar i shoqërisë përbehet nga kontributi i përbashkët i ortakëve themelues në shumën 5000.000 ( pesmilion ) leke, të depozituara pranë noterit.

4.2. Përqindjet e secilit ortak në kapitalin themeltar janë:

- Ilir Shtufi	40%	te kapitalit
- Arben Pellumbi	30%	"
- Adrian Doçi	30%	"

4.3. Kapitali themeltar mund të shtohet në vartësi të rezultateve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai mund të shtohet edhe me anë të kontributeve në natyrë, ku përfshihen edhe të gjitha sendet e paluajtshme, makineritë dhe pajisjet e illojeve të ndryshme që kalojnë ose vijne në porosi të shoqërisë.

4.4. Kapitali themeltar mund të transferohet jashtë shoqërisë tek persona të tjerë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, ose të lihet peng, me miratimin e Asamblesë së Ortakëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.5. Kapitali themeltar është lirish i transferueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkeshortja, paraardhësit ose pasardhësit mund të behen ortakë, nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar me miratim të Asamblesë së Ortakëve.

4.6. Kapitali themeltar ndahet në kuota të barabarta me vlerë nominale 1000 ( njëmijë ) leke secila.

### 5. Fondet e shoqërisë

5.1. Shoqëria përcakton fondet e mëposhteme:

1. Fondin themeltar (qarkullues)
2. Fondin Rezerve.
3. Fonde të tjera, të cilat mund të jenë të nevojshme gjatë veprimtarisë.

5.2. Masa e sejcilit fond dhe menyra e perdorimit te tij, percaktohen me vendim te organit drejtues te shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

## 6. ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

6.1. Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

6.2. Asambleja e Ortakeve, si rregull mbledhet nje here ne vit. Ajo mund te mbledhet edhe me shpesh, kur nje gje e tille e kerkoj njeri prej ortakeve. Per mbledhjen e Asamblese, ortaket duhet te njoftohen te pakten 15 dite perpara me leter rekomande ose me faks. Ne mesazhin e njoftimit duhet te jete percaktuar, vec te tjerave dhe rendi i dites.

6.3. Si rregull mbledhjet e asamblese se Ortakeve mbahen ne seline e Shoqerise ne Vore. Ato mund te mbahen edhe ne ndonje vend tjetet per te cilin ortaket bien dakort.

6.4. Vendimet e Asamblese se Ortakeve meren me shumice votash. Çdo ortak ka numurin e votave te barabarte me perqindjen e tij ne kapitalin themeltar.

6.5. Per zhvillimin e mbledhjeve te asamblese eshte e domosdoshme pjesmarrja e ortakeve qe perfaqesojne 2/3 e kapitalit te shoqerise.

6.6. Ndryshimet ne statutin e shoqerise, vendosen me unanimitetin e te gjithe ortakeve, pavaresisht nga perqindja e kapitalit qe zoterojne ata.

6.7. Asambleja e Ortakeve ka keto kopetenca:

- a. Zgjedh ose emerone Administratorin e shoqerise, qe mund te jete nga radhe e ortakeve.
- b. Miraton politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saj.
- c. Miraton emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel.
- d. Shqyrton bilancin vjetor dhe percakton kuotat e fondeve te ndryshme si dhe fitimin, qe do t'u ndahet ortakeve ne perputhje me kontributin e tyre.
- e. Vendos me unanimitet per shndrimin e shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te llojeve te tjera.
- f. Vendos per marrjen e kredive.
- g. Miraton kontratat me te rendesishme me persona te tjere fizike dhe juridike, duke percaktuar per cdo vit vleren konkrete minimale per tu konsideruar nje kontrate si e tille.

6.8. Administratori ka keto kopetenca:

- a. Realizon mardheniet e ndryshme juridike me persona te tjere fizike dhe juridike.
- b. Percakton çnimet e shitjes dhe te sherbuneve te tjera.
- c. Miraton pagat per personelin qe do te punosohet ne shoqeri.
- d. Kujdeset per funksionimin e perditshem dhe normal te shoqerise, koordinon veprimatrine e tyre me stafin e shoqerise.
- e. I propozon Asamblese se Ortakeve emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel, ndarjen e fitimit, kuotat e fondeve te ndryshme, krijimin e filialeve dhe te perfaqesive, marrjen e kredive, lidhjen e kontratave te rendesishme.
- f. I propozon Asamblese se Ortakeve rregulloren e shoqerise si dhe rregullat per sektore te

- vecante te veprimtarise se saj.
- g. Pergatit dokumentacionin dhe raporte te ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet asamblese se ortakeve.
  - h. Kujdeset per ndjekjen e problemeve te shoqerise me organet e ndryshme shtetore.

## **7. EKSPERTI KONTABEL**

7.1. Aktiviteti financiar i shoqerise kontrollohet nga nje ose disa eksperte kontabel, te cilet emrohen ne perputhje me piken c te paragrafit 6.7.

7.2. Emerimi i ekspertit kontabel eshte i detyrueshem per raste te parashtuara ne ligj.

7.3. Eksperti kontabel ka per detyre shqyrtimin e bilancit vjetor, menyren e mbajtjes se regjistrit te veprimeve kontabel, etj.

## **8. MENYRA E PERFAQESIMIT**

8.1. Shoqeria perfaqesohet nga Administratori i saj.

8.2. Shoqeria mund te perfaqesohet edhe nga persona te tjere te paisur me autorizim te vecante nenshkruar nga Administratori.

## **9. NDARJA E FITIMIT**

9.1. Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve, shpenzimeve te ndryshme, pagave te punonjesve etj., ortakeve u mbetet ne dispozicion fitimi neto.

9.2. Fitimi neto ndahet:

1. Ne pjesen per zgjerimin e kapitalit dhe te fondeve te ndryshme te shoqerise.
2. Nepermjet ortakeve sipas kushtit te parashikuar ne piken d te paragrafit 6.7.

## **10. KOHEZGJATJA**

10.1. Kjo shoqeri krijohet per nje periudhe mbi 10 vjet.

10.2. Cdo ortak mund te largohet nga shoqeria para ketij afati ne perputhje me kontraten dhe legjislacionin ne fuqi.

## **11. MARDHENIET E PUNESIMIT**

Çdo person do te punesohet ne shoqeri mbi bazen e kontrates se punes te lidhur ndermjet tij dhe administratorit, ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi.

## **12. KONFIDENCIALITETI**

Ortaket si dhe te gjithë personat, qe do te perbejne personelin e shoqerise, jane te detyruar te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, te njohurive dhe pervojës se shkëmbyer si

dhe te cdo lloj materjali tjetër konfidencial dhe duhet te adaptoje te gjitha masat e nevojshme per te parandaluar perhapjen e tyre qofte edhe pjeserisht.

### 13. MBARIMI I SHOQERISE

- 13.1 Veprimtaria e shoqerise nbaron me vendim te Asamblese se Ortakeve, ne rast se aktiviteti i saj nuk rezulton fitimprures. Shoqeria mund te mbaroje edhe per shkaqe te tjera ligjore.
- 13.2 Shoqeria mund te mbaroje edhe me ane te riorganizimit nepermjet formave te ndarjes, thithjes dhe bastkimit.
- 13.3 Faza e likuidimit realizohet ne perputhje, me legjislacionin ne fuqi.

### 14. JURIDIKSIONI

Cdo mosmarreveshje ndermjet ortakeve, qe nuk mund te zgjidhen me pajtim, i referohet per shqyrtim Gjykates se Rrethit Tirane.

### 15. DISPOZITA TE FUNDIT

- 15.1 Viti financiar i shoqerise fillon me 01 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
- 15.2 Pasuria e shoqerise mund te sigurohet ne cdo shoqeri apo Institut sigurimi.
- 15.3 Shoqeria do te ketë vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles percaktohet nga Asamblea e Ortakeve te shoqerise.

Ne mbledhjen e saj te vecante Asamblea e Ortakeve te Shoqerise "FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO" sh.p.k. me unanimitet zgjodhi si administrator zotin ILIR SHTUFI. Po ne kete mbledhje Asamblea e Ortakeve te Shoqerise miratoi me unanimitet edhe kete statut te shoqerise.

### THEMELUESIT E SHOQERISE "FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO"

ADRIAN DOCI

Republika e Shqiperise  
Doma e noterise Tirane

ORTAKET  
ILIR SHTUFI

ARBEN PELLUMBI

Nr 818 Rep.  
Nr 144 Kol.

Vertetim

Sot, me daten 5/2/2002 u paraqiten para meje Agim Robo, noter ne noterine e Tiranes Arben Pellumbi me pas. nr. 1581159, Ilir Shtufi me nr. pas. 1709513 dhe Adrian Doçi me pas. nr. 1591064, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet me deklaruan se jashte zyrave te noterise kane hartuar statutin e shoqerise "FERRO - BETON & CONSTRUCTION CO" sh.p.k te cilin e nenshkruan lirisht para meje.

Une noter i e vertetoj rregullisht sipas ligjit.

Noteri

